



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUSTEC

Nr. ____ Prot

Pustec, më _____.____.2025

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Studim Projektim”Rikonstruksion i diges se rezervuarit Lajthize 1,2,3.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
71322400-5 Shërbime per Projektim Digash**

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **4 032 360 (kater milione e tridhjetë e dy mijë e treqind e gjashtedhjetë) lek pa TVSH**

Sqarim: Referuar VKM Nr .354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim” u përllogarit dhe fondi limit si më poshtë:

Vlera e investimit e parashikuar përafërsisht nga Bashkia Pustec për objektet: **“Studim Projektim”Rikonstruksion i diges se rezervuarit Lajthize 1,2,3.** është 46,000,000 lekë pa Tvsh.

- Objekti i mësipërm bën pjesë në: **Seksioni III “Vepra Inxhinjerike”.**

A - Për këtë në bazë të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, u hap faqja e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik nga ku u morrën dokumentat standarte të tenderit. Këto dokumenta u përzgjedhen për procedurën e përcaktuar në Urdherin e Prokurimit Nr.7 datë 11.06.2025 dhe u procedua si më poshtë:

1. U plotësuan dokumentat e tenderit të mësipërm sipas Dokumentave Standarte të tenderit dhe u përgatiten për hedhjen në sistem.
2. Kërkesat e Përgjithshme për kualifikim të mbeten ato që përcaktohen në Dokumentat Standarte.
3. Kërkesat e veçanta për kualifikim të vendosen si më poshtë:

Për përlllogaritjen e fondit limit, AK i është VKM Nr .354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim” u përlllogarit dhe fondi limit si më poshtë:

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Pustec** ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1.Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”

b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3; Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 80 647 (tetedhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e shtate) lekë pa Tvsh**, të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të vërtetuar të bilancit të vitit 2022,2023, 2024, të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit

të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin

financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme , nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", (i ndryshuar), Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", (i ndryshuar), si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja "c" të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël**".

2.2.2 Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2022, 2023,

2024) nga data e publikimit te tenderit lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilës duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se 40% të vleres se fondit limit qëprokurohet,

Kjo pike konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedurës është “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, gërma “c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë 41. Riformuluar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021 43 Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021 46 intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Gjithashtu përcaktimi i kërkesës për paraqitjen e këtij dokumenti përcaktohet dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të nenit 43, pika 1 ” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, për vitin 2024 ,pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar dhe për vitin 2025 sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimet në nenin 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohej sqarime nga autoriteti kontraktor.

* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), si dhe ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” (i ndryshuar), neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024, pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera (realizuara) gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, me një vlerë jo më të vogël 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe në nenin 41 pika 3 si dhe Nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

- 2.3.2 **Licensat profesionale të operatorit ekonomik (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licencave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategoritë:**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për **Projektim** të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në vendimin nr. 759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari të koaludimit të punimeve të zbatimit në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes ndërtim", ndryshuar me VKM-në nr. 943 datë 28. 12.2016", me kategoritë si më poshtë:

1. PROJEKTUES ARKITEKT

Kat. 2/d – Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.

Argumentimi. Kjo kategori siguron integrimin harmonik të infrastrukturës rrugore me mjedisin përreth përmes zgjidhjes estetike të hapësirave të gjelbra dhe elementëve të peizazhist, duke përmirësuar cilësinë vizuale dhe ekologjike të projektit.

2. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

Kat 3/a - Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate

Kat. 3/c – Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme – metalike – 2. troje dhe shpate me qëndrueshmëritë ulët.

Kat. 3/d- Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike;

Argumentimi. Këto kategori janë thelbësore për projektimin e strukturave mbajtëse dhe elementëve të tjerë konstruktivë që sigurojnë qëndrueshmërinë e strukturave ndaj ngarkesave statike dhe dinamike, si dhe qëndrueshmërinë e shtresave dhe kapaciteteve mbajtëse metalike dhe beton-arme.

3. PROJEKTUES INSTALATOR

Kat. 4/c – Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale

Kat. 4/f – Projektim të sistemeve kundra zjarrit

Kat. 4/g – Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa

Kat. 4/i - Projektimi i ndricimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndricimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve, etj.

Kat. 4/j - Projektim të rrjeteve të telefonise, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për objektet civile dhe industriale

Argumentimi. Përfshijnë projektimin e sistemeve elektrike, telekomunikacionit, ndricimit dhe komandimit.

Projektimi i sistemeve kundra zjarrit është nevojshëm për projektet dhe garanton që projektuesi ka kompetencat e nevojshme për të integruar sistemet e mbrojtjes nga zjarri në infrastrukturën rrugore, këto kategori sigurojnë projektimin e materialeve dhe sistemeve që përmbushin standardet e rezistencës ndaj zjarrit, duke mbrojtur integritetin e strukturës.

4. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

Kat. 5/a – Projektim diga të mëdha.

Kat. 5/b – Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi..

Kat. 5/d - Projektim vepra ujitje-kullimi-impianthe vaditëse-diga të vogla-damba, sifona, kaskada, kapërdredhës, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino

Kat. 5/f - Projektim vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi, shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuaret, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrje e ujit me puse.

Argumentimi. Keto kategori sigurojnë projektimin e duhur të digave të mëdha të digave të vogla të drenazhimit dhe kullimit të kolektoreve të shkarkimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore etj që ndikojnë drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë e infrastrukturës rrugore.

5. PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA

Kat. 6/a – Projektim rruge lokale, rruge urbane dytesore dhe rruge interurbane dytesore.

Argumentimi. Kjo kategori siguron projektimin e rrugëve sipas standardeve teknike të qarkullimit, duke garantuar zgjidhje funksionale për trafikun dhe sigurinë rrugore.

6. PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI

Kat. 7/a – Ura dhe vepra arti të vogla deri më 10 m.

Argumentimi. Siguron projektimin e strukturave të rëndësishme që mundësojnë vazhdimësinë e rrugëve në zonat me pengesa natyrore. Ekspertiza në këtë fushë garanton qëndrueshmërinë, sigurinë dhe funksionalitetin e këtyre elementëve kritikë të infrastrukturës, duke mundësuar lidhje të sigurta transporti dhe zgjidhje estetike për kalimet urbane dhe rurale.

7. PROJEKTUES GJEODET

Kat. 8/a – Rilevime inxhinierike.

Kat. 8/b – Rilevime inxhinierike kadastrale.

Kat. 8/c – Sistemet GIS

Argumentimi. Kategori të domosdoshme për hartimin e plan rilevimit të terreneve që do të zhvillohen. Keto kategori mundësojnë hartimin e planeve të sakta të terrenit që shërbejnë si bazë për vendosjen e objekteve dhe projektimin e niveleve të rrugëve. Gjithashtu, sigurojnë që projektet të realizohen brenda kufijve ligjorë të pronave, duke parandaluar konfliktet dhe problemet juridike gjatë zbatimit të punimeve.

8. STUDIM GJEOLIGO-INXHINIERIK – HIDROGJEOLOGJIK

Kat.9/a - Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri në 5 kate

Kat. 9/d – Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.

Kat. 9/e – Studime e projekte hidrogeologjike.

Argumentimi. Studimet gjeologo-inxhinierike dhe hidrogeologjike janë kritike për projektimin e rrugëve dhe fasadave pasi sigurojnë vlerësimin e qëndrueshmërisë së terrenit ku do të ndërtohen këto struktura. Keto kategori janë thelbësore për identifikimin e rreziqeve gjeologjike si rrëshqitjet e tokës dhe problemet me ujërat nëntokësore që mund të komprometojnë stabilitetin e rrugëve ose themeleve të ndërtesave. Gjithashtu, mundësojnë projektimin e masave inxhinierike për të garantuar qëndrueshmëri afatgjatë dhe sigurinë e infrastrukturës rrugore dhe ndërtesave ku aplikohen fasadat.

9. PROJEKTIMI I IMPIANTEVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

Kat. 10/e – Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm

Argumentimi. Kjo licence është e domosdoshme për projektimin e rrugëve dhe fasadave pasi përfshin projektimin e kabinave elektrike të rrjetit shpërndarës, linjave të tensionit të ulët dhe të mesëm. Kjo kategori siguron furnizimin e qëndrueshëm me energji elektrike për sistemet e ndriçimit rrugor dhe pajisjet e tjera elektrike të infrastrukturës rrugore. Gjithashtu, është thelbësore për projektimin e sistemeve elektrike që furnizojnë ndërtesat, përfshirë fasadat me elementë të ndriçuar apo sisteme të tjera që kërkojnë energji elektrike.

10. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR.

Kat. 11/a – Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

Kat. 11/d – Projektim sinjalistike ndricuese në infrastrukturë

Argumentimi. Keto kategori janë te domosdoshme pasi sigurojnë që projektuesi ka kompetencat për të krijuar sisteme sinjalizimi që përmbushin standardet e sigurisë rrugore. Keto kategori garantojnë aftësinë për projektimin e sinjalistikës horizontale dhe vertikale në situata komplekse si kryqëzimet dhe zonat urbane. Për projektet e fasadave, keto kategori janë te rëndësishme për të siguruar integritetin e sigurt të daljes nga objektet në rrugë dhe sinjalizimin e duhur të hyrje-daljeve.

11. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE

Kat. 12/a .Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve.

Kat. 12/c .Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj.

Argumentimi. Keto kategori janë te domosdoshme pasi sigurojnë që projektuesi të bëjë studime dhe vlerësime sizmologjike të trojeve ku ndërtohen objektet të infrastruktures rrugore hekurudhore etj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licensat e mësipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 6 punonjës në listëpagesa sipas formularëve standarte për sigurimet, për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (nëpërmjet formës elektronike). Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

- 1 (një) projektues Arkitekt
- 1 (një) projektues Inxhinier Ndërtimi;
- 1 (një) projektues Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (një) projektues Inxhinier Gjeolog
- 1 (një) projektues Inxhinier Gjeodet
- 1 (një) projektues Inxhinier Elektrik
- 1 (një) projektues Inxhinier Mekanik

Operatori ekonomik duhet të paraqesë për stafin sa më sipër kërkuar:

- a) **Kontratat individuale të punës (të vlefshme),**
- b) **Licencat profesionale sipas kategorisë që përfaqëson**
- c) **Diplomë,**
- d) **CV**

***Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 10. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.**

1. Personeli Kryesor per Projektim

ARKITEKT 1

Argumentimi. Projektuesi Arkitekt, siguron integrimin harmonik të infrastrukturës rrugore me mjedisin përreth përmes zgjidhjes estetike të hapësirave të gjelbra dhe elementëve të peizazhist. Përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol kryesor në projektim/studime për (ri)ndërtimin/rehabilitimin e infrastrukturës kulluese dhe vaditese me eksperiencë në projektimin e digave, veprave te artit etj.

ING NDERTIMI 1

Argumentimi. Konsiderohen të nevojshëm për hartimin e projektit të zbatimit dhe relacionit përkatës sipas përcaktimeve në detyrën e projektimit. Në përmbledhje, një **projektues inxhinier ndërtimi** është përgjegjës për planifikimin dhe projektimin e projekteve ndërtimi që janë të qëndrueshme, të sigurta dhe të përputhshme me standardet e kërkuara, duke siguruar që ato të jenë të realizueshme ekonomikisht dhe teknologjikisht.

- Siguron që të gjitha strukturat të jenë të qëndrueshme dhe të sigurta për përdoruesit e tyre.
- Optimizon projektet për të ulur kostot dhe për të arritur rezultatet më të mira në aspektin e kohës dhe burimeve, përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol kryesor në projektim/studime për (ri)ndërtimin/rehabilitimin e infrastrukturës kulluese dhe vaditese me eksperiencë në projektimin e digave, veprave te artit etj. Ai/ajo do të jetë përgjegjës për projektimin te strukturave mbajtese.

- Siguron që projektet të jenë në përputhje me ligjet dhe rregullat, përfshirë ato për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë.

ING GJEOLÓG 1

Argumentimi. Inxhinieri gjeolog është i nevojshëm pasi do të hartojë raporte të detajuara për karakteristikat e terrenit dhe ndikimin që mund të kenë ato në projektin e infrastrukturës dhe ndërtesës, duke studiuar dhe analizuar karakteristikat gjeologjike të terrenit ku do të zbatohet projekti. Kjo përfshin analiza të dheut, shkëmbinjve dhe ujërave në sipërfaqe, për të vlerësuar stabilitetin dhe sigurinë e mundshme gjatë ndërtimit dhe përdorimit. Gjithashtu inxhinieri gjeolog identifikon dhe vlerëson mundësinë e fenomeneve natyrore të tilla si rrëshqitjet e dheut, përmytjet, dhe tërmetet, përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol kryesor në projektim/studime për (ri)ndërtimin/rehabilitimin e infrastrukturës kulluese dhe vaditese me eksperiencë në projektimin e digave, veprave të artit etj.

ING GJEODET 1

Argumentimi. Inxhinieri gjeodet për projektim është thelbësor për sigurinë dhe saktësinë e ndërtimit të tyre, pasi siguron matje të sakta të terrenit dhe mundëson planifikimin dhe projektimin në përputhje me realitetin gjeografik dhe gjeoteknik të zonës. Gjeodetët janë të përfshirë në çdo fazë të procesit, nga matjet fillestare deri në mbikëqyrjen e punimeve, duke siguruar që objekti të jetë i qëndrueshëm, i sigurt dhe të përmbushë kërkesat e projektit, përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol kryesor në projektim/studime për (ri)ndërtimin/rehabilitimin e infrastrukturës kulluese dhe vaditese me eksperiencë në projektimin e digave, veprave të artit etj.

ING ELEKTRIK 1

Argumentimi. Inxhinieri Elektrik është i domosdoshëm për projektimin e kabinave elektrike të rrjetit shpërndarës, linjave të tensionit të ulët dhe të mesëm, përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol kryesor në projektim/studime për (ri)ndërtimin/rehabilitimin e infrastrukturës kulluese dhe vaditese me eksperiencë në projektimin e digave, veprave të artit etj.

Ai/ajo do të jetë përgjegjës për projektet mekanike, sinjalistike dhe automatizimit të veprave të komandimit.

ING HIDROTEKNIK 1

Argumentimi. Inxhinieri hidroteknik është thelbësor në projektimin pasi siguron që uji, një nga faktorët më të rëndësishëm për qëndrueshmërinë, të menaxhohet në mënyrë të sigurt dhe të efektshme. Duke projektuar sisteme të drenazhimit, parandalimin e përmytjeve dhe menaxhimin e ujërave, inxhinieri hidroteknik ndihmon në ndërtimin e diges që të jete e qëndrueshme, e sigurt dhe e mbrojtur nga ndikimet e ujit, përvojë rajonale/ndërkombëtare në një rol kryesor në projektim/studime për (ri)ndërtimin/rehabilitimin e infrastrukturës kulluese dhe vaditese me eksperiencë në projektimin e digave, veprave të artit etj.

ING MEKNIK 1

Argumentimi. Inxhinieri mekanik është i domosdoshëm dhe përgjegjës për projektet mekanike, sinjalistike dhe automatizimit të veprave të komandimit, përvojë rajonale/ndërkombëtare në një

rol kryesor në projektim/studime për (ri)ndërtimin/rehabilitimin e infrastrukturës kulluese dhe vaditese me eksperiencë në projektimin e digave, veprave te artit etj.

2.3.4 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

- **1 (nje) Ekspert për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis si dhe QKL për hartimin e raporteve të ndikimit në mjedis.**

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diplomën,
- Kontratën individuale të punës (të vlefshme),
- Certifikatën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (*i ndryshuar*) dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (*i ndryshuar*), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar detyrës së projektimit për kete objekt pjesë e kësaj procedure, pjesë e së cilave do të jenë të licencuar për shërbimet që priten të realizohen.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për stafin mbështetës si më poshtë:

1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë të lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis,

Gjykohet si i domosdoshëm për realizimin e VNM (Vlerësimet e ndikimit në Mjedis) për projektet që do të realizohen.

Raporti VNM do të përfshijë përshkrimin e projektit, analiza e ndikimeve, identifikimi i masave për parandalimin ose minimizimin e ndikimeve negative, dhe rekomandime për zbatimin e masave të lehtësimit.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

- a) ISO 9001: 2015, Për menaxhimin e cilësisë;
- b) ISO 14001: 2015, Për menaxhimin e cilësisë së mjedisit;
- c) ISO 45001: 2018, Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë;

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit” Çertifikatat e cilësisë janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

a) ISO 9001: 2015, Për menaxhimin e cilësisë;

Certifikata e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë (Quality Management System - QMS): Ky standard ka të bëjë me menaxhimin e cilësisë dhe sigurimin e proceseve të projektit. Certifikimi sipas ISO 9001 konfirmon se studioja ka vendosur standarde të larta për proceset e saj dhe ka një sistem efektiv të menaxhimit të cilësisë.

b) ISO 14001: 2015, Për menaxhimin e cilësisë së mjedisit;

Certifikata e Sistemit të Menaxhimit të Ambientit (Environmental Management System - EMS): Një studio projektuese që merret me dizajnimin e projekteve ndikon në ambientin, kështu që certifikimi sipas ISO 14001 tregon që studioja angazhohet për të pasuruar mjedisin dhe t’i minimizojë ndikimet negative në të.

c) ISO 45001: 2018, Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë;

Certifikata e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (Occupational Health and Safety Management Systems - OHSMS): Ky standard konfirmon se studioja ndjek një sistem efektiv të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit të punonjësve të saj, duke garantuar një mjedis pune të sigurtë dhe të shëndetshëm për ekipin e saj.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë në pronësi ose me qera, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- 1(një) Pajisje për matjet gjeodezike GPS;
- 1(një) Pajisje për matjet gjeodezike Total Station.
- 1(një) Pajisje dron profesional
- 2(dy) Automjet

Për plotësimin e kësaj kërkeje duhet të paraqitet një dokument i cili vërteton pronësinë ose aktin e marrjes me qera të tyre si dhe skeda teknike e këtyre pajisjeve.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 10. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Njësia e prokurimit